“Disa njerëz po zhyten në pasurinë e Allahut padrejtësisht. Ditën e Kiametit, të tillët i pret Zjarri.”

Havle Ensarija (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Disa njerëz po zhyten në pasurinë e Allahut padrejtësisht. Ditën e Kiametit, të tillët i pret Zjarri.”

[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Profeti lajmëroi për disa njerëz që i përdorin pasuritë e muslimanëve padrejtësisht dhe i marrin ato pa hak. Ky është një kuptim i përgjithshëm i pasurisë, për sa i përket grumbullimit dhe fitimit të saj në mënyrë të paligjshme dhe shpenzimit të saj në vende të gabuara. Këtu përfshihet ngrënia e pasurisë së jetimëve dhe pasurisë së institucionit të vakëfit. Gjithashtu përfshihet mohimi i amaneteve dhe marrja padrejtësisht nga fondet publike. Më pas Profeti lajmëroi se të tillët do të dënohen me zjarr në Ditën e Kiametit.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5331